



Partnerët Shqipëri
Qendra për Ndryshim
dhe Manaxhim Konflikti



PJESËMARRJA E SHOQËRISË CIVILE DHE QYTETARËVE NË VENDIMMARRJE

NJË STUDIM MBI KUADRIN LIGJOR
RREGULLATOR DHE PRAKTIKËN NË SHQIPËRI



PJESËMARRJA E SHOQËRISË CIVILE DHE QYTETARËVE NË VENDIMMARRJE

NJË STUDIM MBI KUADRIN LIGJOR
RREGULLATOR DHE PRAKTIKËN NË SHOIPËRI

Ky botim u përgatit nga Partnerët Shqipëri, Qendra për Ndryshim dhe Manaxhim Konflikti. Përgatitja dhe publikimi i tij u mundësua me mbështetjen e Olof Palme International Centre në Shqipëri dhe financim të Qeverisë Suedeze në kuadër të projektit “Rritja e pjesëmarrjes qytetare në hartimin dhe zbatimin e politikave”.

Mendimet dhe opinionet e shprehura në këtë publikim nuk reflektojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Olof Palme International Centre dhe të Qeverisë Suedeze.

Partnerët Shqipëri falënderon organizatat e shoqërisë civile, përfaqësuesit e pushtetit vendor dhe ekspertët në bashkitë respektive të cilët dhanë mendimet e tyre dhe bashkëpunuan në realizimin e këtij studimi.

Punoi:

Ariola Agolli

Blerina Guga

Elona Kapexhiu

Pasqyra

1.	Hyrje	5
2.	Metodologjia	7
3.	Çfarë është Pjesëmarrja Qytetare?	8
3.1	Nivelet e Pjesëmarrjes Qytetare	10
4.	Shoqëria Civile dhe Roli i OJFve në Nxitjen e Angazhimit Qytetar dhe Proceset Vendimmarrëse	11
5.	Korniza Aktuale Ligjore dhe Rregullatore mbi Pjesëmarrjen Qytetare ...	15
5.1	Kushtetuta e Shqipërisë	16
5.2	Kuadri ligjor për të Drejtën e Organizimit	19
5.3	Kuadri Ligjor për Mobilizimin e Burimeve dhe Kufizimet Kryesore	21
5.4	Kuadri Ligjor për Lirinë e Shprehjes dhe të Drejtën e Informimit	23
5.5	Ligje dhe Rregullore të Tjera	27
6.	Analiza e Gjetjeve të Vrojtimit mbi Angazhimin e Shoqërisë Civile në Proceset Vendimmarrëse	35
6.1	Analiza e Kampionit	36
6.2	Aksesi në Informacion e Dokumente Publike dhe Marrëdhëniet me Publikun	38
6.3	Bashkëpunimi Ndërmjet Organizatave të Shoqërisë Civile dhe Pushtetit Vendor	45
6.4	Partneriteti OJF – OJF	51
7.	Përfundime dhe Rekomandime	54
8.	Referenca	58

SHKURTIMET

AMSHC	Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile
DPP	Drejtoria e Përgjithshme e Politikave
IT	Teknologjia e Informacionit
DPPPP	Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave
ECNL	European Center for Not-for-Profit Law Qendra Evropiane për Ligjin Jofitimprurës
HDPC	Human Development Promotion Centre Qendra për Promovimin e Zhvillimit Human
MPCSSHB	Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta
NJPV	Njësi e Pushtetit Vendor
OECD	Organisation for Economic Co-operation and Development Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim
OJF	Organizatë Jofitimprurëse
PSh	Partnerët Shqipëri, Qendra për Ndryshim dhe Manaxhim Konflikti
PV	Pushtet Vendor
TACSO	Technical Assistance for Civil Society Organisations Asistenca Teknike për Organizatat e Shoqërisë Civile
TVSH	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar
UNECE	United Nations Economic Commission for Europe Komisioni Ekonomik i Kombeve të Bashkuara për Evropën
ZIQ	Zyra e Informimit Qytetar

1. Hyrje

Ky botim është përgatitur nga Partnerët Shqipëri, Qendra për Ndryshim dhe Manaxhim Konflikti. Ai paraqet raportin e studimit mbi kuadrin ligjor dhe rregullator për shoqërinë civile dhe angazhimin qytetar në Shqipëri, kryer nga PSh gjatë vitit 2012. Studimi është zhvilluar në kuadër të projektit “Rritja e pjesëmarrjes qytetare në hartimin dhe zbatimin e politikave” mbështetur nga Olof Palme International Centre në Shqipëri, me financim të Qeverisë Suedeze.

Qëllimi kryesor i studimit ishte vlerësimi i kuadrit ligjor dhe mundësues si dhe niveli i angazhimit dhe pjesëmarrjes së qytetarëve dhe shoqërisë civile në proceset vendimmarrëse në Shqipëri.

Studimi paraqet një përmbledhje të kornizës ligjore dhe rregullatore që ndikon në pjesëmarrjen dhe angazhimin qytetar duke përfshirë: parimet, të drejtat dhe liritë themelore të sanksionuara në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, ligje dhe rregullore që ndikojnë të drejtën e organizimit, lirinë e shprehjes, të drejtën e informimit, etj.

Si pjesë e tij ai ofron informacion mbi konceptet bazë të pjesëmarrjes qytetare, niveleve, llojeve, rëndësisë që ajo ka, si dhe mbi rolin e shoqërisë civile në angazhimin qytetar.

Një vend kryesor në studim ze vlerësimi i angazhimit të organizatave të shoqërisë civile dhe grupeve të interesit që ato përfaqësojnë në proceset vendimmarrëse në nivel vendor dhe qendror, faktorët mundësues dhe sfidat e ndeshura gjatë përvojës së tyre.

Në botim përfshihen edhe rekomandimet e dala gjatë vrojtimit të zhvilluar me 100 OJF në dhjetë bashki në vend, e gjatë intervistave e takimeve në grupe të fokusuara me përfaqësues të shoqërisë civile, ekspertë, përfaqësues të pushtetit vendor e aktorë të tjerë lokalë.

Gjetjet dhe rekomandimet e këtij studimi do të përdoren për të promovuar reforma në nivel lokal e qendror për nxitjen e përfshirjes së aktorëve të shoqërisë civile dhe qytetarëve në vendimmarrje, përfshirë hartimin, zbatimin dhe monitorimin e politikave në të gjitha nivelet qeverisëse.

2. Metodologjia

Objektivat e studimit:

- Krijimi i një panorame të përgjithshme të kuadrit ligjor e rregullator që garanton pjesëmarrjen qytetare në politikëbërjen në nivel vendor e qendror;
- Vlerësimi i nivelit të angazhimit dhe identifikimi i sfidave të pjesëmarrjes së shoqërisë civile në proceset vendimmarrëse;
- Identifikimi i prioriteve për reforma në kuadrin ligjor dhe rregullator dhe për nxitjen e bashkëpunimit e dialogut ndërmjet organizatave të shoqërisë civile dhe qeverisë.

Për të realizuar këtë studim PSh përdori mjetet e mëposhtme të hulumtimit:

- Studim i dokumentacionit ligjor dhe rregullator shqiptar, si dhe i raporteve dhe botimeve të organizatave e institucioneve kombëtare dhe ndërkombëtare, lidhur me pjesëmarrjen qytetare dhe zhvillimin e saj;
- Vrojtim i realizuar nëpërmjet administrimit të një pyetësori me 100 OJF në Berat, Durrës, Elbasan, Gjirokastrë, Korçë, Kukës, Lezhë, Pukë, Shkodër, Tiranë e Vlorë.
- Intervista të drejtpërdrejta dhe fokus grupe me përfaqësues të shoqërisë civile, pushtetit vendor, ekspertë e aktorë të tjerë në qytetet e sipërpërmendura;
- Vrojtim në terren dhe monitorim i faqeve të internetit të NJQVve. Ky mjet u përdor për monitorimin e aksesit në informacion për çështje me interes publik, llojin dhe cilësinë e informacionit në dispozicion të qytetarit, etikën e komunikimit me qytetarët në NJQV etj.

3. Çfarë është Pjesëmarrja Qytetare?

Pjesëmarrja qytetare mund të shihet si një proces në të cilin shqetësimet, nevojat, vlerat, pritshmëritë dhe problemet e qytetarëve merren parasysh në procesin vendimmarrës të qeverisë. Pjesëmarrja qytetare është një proces komunikimi i dyanshëm mes qeverisë dhe qytetarëve, me qëllim marrjen e vendimeve më të mira, të mbështetura nga publiku dhe nxitjen e rritjes së mirëqënies së popullsisë e reduktimin e varfërisë.

Pjesëmarrja civile përfshin tre elementë të ndërlidhur me njëri tjetrin:

- Qeveri të hapur dhe transparente, duke përfshirë qytetarët në tërësinë e aktiviteteve të saj dhe procesin e vendimmarrjes;
- Dhënie informacioni të qëndrueshëm dhe të vazhdueshëm nga qeveria drejt qytetarëve dhe anasjelltas; dhe
- Mënyra sa më efektive për të informuar qytetarët të kuptojnë rolet dhe përgjegjësitë e tyre për të qenë pjesëmarrës si partnerë të barabartë.

Pjesëmarrja qytetare është kombinimi i këtyre tre elementëve, në mënyrë që planet e qeverisë të zhvillohen dhe zbatohen në bashkëpunim, për t'iu përgjigjur sa më mirë nevojave dhe dëshirave të qytetarëve. (Chetwynd and Chetwynd, 2001).

Një dimension i rëndësishëm i pjesëmarrjes qytetare është mënyra se si ndërtohet marrëdhënia ndërmjet institucioneve dhe aktorëve të ndryshëm përmes shpërndarjes së autoritetit. Këtij dimension i kushtoi një vëmendje të veçantë sociologjia amerikane Sherry Arnstein, e cila që në 1969 publikoi hulumtimin mbi rolin historik të pjesëmarrjes qytetare në procesin e vendimmarrjes. Arnstein argumentoi se pjesëmarrja qytetare është një "term përcaktues për fuqinë e qytetarëve", duke qenë se ajo duhet të shkojë përtej thjesht rolit vëzhgues të qytetarëve dhe pjesëmarrjes joaktive, sepse publiku nuk është një aktor pasiv, por një agjent që ka fuqinë të ndryshojë

dhe influencojë mënyrën se si menaxhohen çështjet publike. Kështu, është e qartë se pjesëmarrja qytetare nuk është thjesht pjesë e përshkrimit të marrëveshjeve të veçanta institucionale për vendimmarrjen, por pjesë e autoritetit i cili realisht merr vendimet.

Sipas shkencëtarëve politikë si Robert Dahl, demokracitë duhet të sigurojnë mundësi të barabarta dhe të përshtatshme për pjesëmarrjen e qytetarëve. Këto mundësi duhet t'u garantojnë qytetarëve: a) të vendosin çështjet prioritare në axhendë; b) të shprehin pikëpamjet e tyre mbi këto çështje; c) të ushtrojnë autoritet (nëpërmjet votimit ose ndonjë forme tjetër). Të tria këto të drejta janë të sanksionuara në Traktatin e Lisbonës dhe, si për Bashkimin Evropian si një i tërë ashtu edhe për secilin prej shteteve anëtare të tij, paraqesin sfida domethënëse për t'u përballuar dhe qëndrojnë si standarde të dobishme për ato shtete të cilat kërkojnë të bëhen pjesë e BE. Traktati synon të mbështesë një Evropë më demokratike dhe transparente, me një rol më të fuqizuar të Parlamentit Evropian dhe parlamenteve kombëtare, një kuptim më të qartë se cili bën çfarë në nivel evropian dhe kombëtar, dhe më tepër mundësi për qytetarët që t'u dëgjohet zëri.¹

Pjesëmarrja e publikut është një element kyç për demokracinë e një vendi. Shqipëria i është nënshtruar ndryshimeve të mëdha në lidhje me përfshirjen e qytetarëve në hartim politikash, vendimmarrje, procese në lidhje me ligjin dhe formësimin e sistemit të saj demokratik. Megjithatë, mbetet ende sfida (1) informacioni i pakët; (2) kuptimi që qytetarët kanë për të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre, (3) pjesëmarrja e ulët e qytetarëve në proceset vendimmarrëse dhe në hartimin, zbatimin dhe monitorimin e ligjeve (4) zbatimi në mënyrë korrekte i kornizës ligjore nga zyrtarët publikë.

¹ TACSO. (2011) OSHC-të dhe Pjesëmarrja e Qytetarëve në Proceset Vendimmarrëse

3.1 Nivelet e Pjesëmarrjes Qytetare

Sipas metodologjisë së Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OECD), tre janë nivelet e bashkëpunimit ndërmjet qytetarëve dhe autoriteteve në proceset vendimmarrëse²:

Informimi: një marrëdhënie e njëanëshme me anë të së cilës qeveria prodhon dhe shpërndan informacion të vlefshëm për t'u përdorur nga qytetarët. Këtu përfshihet si akses i "pasiv" në informacion si rrjedhojë e kërkesës së qytetarëve, ashtu edhe masat "aktive" të qeverisë për të shpërndarë informacion tek qytetarët.

Konsultimi: një marrëdhënie e dyanëshme në të cilën qytetarët ofrojnë sugjerime për qeverinë. Kjo bazohet në një përcaktim paraprak nga qeveria mbi çështjen për të cilën kërkohen pikëpamjet apo sugjerimet e qytetarëve, dhe kërkon ofrim informacioni.

Pjesëmarrja aktive: një marrëdhënie e bazuar në partneritetin me qeverinë, në të cilin qytetarët angazhohen aktivisht në proceset politikëbërëse. Kjo u jep qytetarëve rolin për të dhënë mendime mbi politikën dhe hartimin e dialogut për këto politika, megjithëse përgjegjësia për vendimin apo formulimin final të politikës i mbetet qeverisë.

² OECD. OECD Public Management, Policy Brief Engaging Citizens in Policy-Making: Information, Consultation and Public Participation. PUMA, Policy Brief No.10, July 2001, fq. 2.

4. Shoqëria Civile dhe Roli i OJFve në Nxitjen e Angazhimit Qytetar dhe Proceset Vendimmarrëse

Ka pak dokumenta e studime mbi zhvillimet e shoqërisë civile në Shqipëri. Të përcaktosh shoqërinë civile është një detyrë e vështirë jo vetëm në një vend si Shqipëria sepse është relativisht një koncept i ri në diskutimet e studiuesve, por edhe në vende me njohje më të thella e me traditë në zhvillimin e sektorit të tretë.

Termi “shoqëri civile”, ka një kuptim funksional dhe i referohet një grupi të gjerë organizatash joqeveritare, vullnetare dhe jofitimprurëse që janë prezente në jetën publike, dhe të cilat kryejnë një gamë të gjerë aktiviteteve për të shtuar vlerat dhe përmbushur interesat e anëtarëve të tyre dhe më gjerë, bazuar në parime etike, kulturore, politike, shkencore, fetare apo filantropike. Ky përkufizim i referohet sferës jashtë familjes, shtetit dhe tregut, dhe përjashton bizneset fitimprurëse, megjithëse këtu mund të përfshihen edhe organizatat e profesionistëve. “Angazhimi qytetar” nënkupton pjesëmarrjen e aktorëve privatë në sferën publike, përmes ndërveprimeve direkte dhe indirekte të OJFve dhe në përgjithësi të qytetarëve me qeverinë, institucionet multilaterale dhe bizneset për të ndikuar në vendimmarrje ose në arritjen e qëllimeve të përbashkëta. Angazhimi qytetar është një proces, përmes së cilit qytetarët apo përfaqësuesit e tyre organizohen që të “influencojnë, hartojnë dhe të kontrollojnë punët publike dhe iniciativat për zhvillim, zbatimin e tyre dhe burimet”.³

Pjesëmarrja dhe angazhimi qytetar në Shqipëri është i lidhur me momentet historike që ka kaluar vendi dhe faktorët ekonomikë, socialë dhe politikë që

3 World Bank. (2009) World Bank - Civil Society Engagement: Review of Fiscal Years 2007 to 2009

i kanë shoqëruar. Të dhënat arkivore tregojnë për ekzistencën e organizimeve të qytetarëve në grupe profesionale (esnafe) apo shoqëri mirëbërëse të paktën që prej viteve 1700. Këto organizma vepronin kryesisht si organizata bamirëse apo shoqëri për zhvillimin e arsimit dhe përhapjen e gjuhës shqipe. Prej kësaj periudhe e deri në krijimin e shtetit shqiptar në vitet 1920, numërohen me dhjetra shoqëri të themeluara në trevat shqiptare dhe diasporë, të cilat në një masë të gjerë kishin karakter politik. Ato ishin të lidhura ngushtë me lëvizjen kombëtare shqiptare, përhapjen dhe zhvillimin e arsimit dhe kulturës. Pas viteve 1920 pati një mungesë të vazhdimësisë së punës së shoqërive, aktiviteti i të cilave në këtë periudhë ishte i shkëputur, sporadik dhe i paorganizuar. Shteti ndërmori një rol më aktiv për zhvillimin e projekteve që synonin të shëronin plagët e shoqërisë. Viti 1922 shënon dhe themelimin e Kryqit të Kuq Shqiptar.⁴

Zbatimi i modelit të socializmit në Shqipëri pas Luftës së II Botërore, do të kishte pasoja të jashtëzakonshme në historinë e vendit dhe në pjesëmarrjen e angazhimit qytetar. Sistemi i ri politik, ekonomik dhe social që u vendos, synonte homogjenizimin e shoqërisë dhe kthimin e saj në një shoqëri një ngjyrëshe si dhe vendosjen e kontrollit mbi çdo sektor të jetës. Gjatë kësaj periudhe angazhimi qytetar u fut në një format të ri në përputhje me interesat dhe ideologjinë e regjimit komunist. Ky format e kufizoi organizimin qytetar në organizma të krijuara nga partia shtet (organizata e rinisë, bashkimet profesionale, organizata e gruas, organizata e veteranëve, fronti demokratik etj). Ndërkohë, angazhimi qytetar nxitej dhe promovohet nën konceptin e punës vullnetare. Në të vërtetë ky organizim dhe vullnetarizëm ishte i detyruar.

Jo çuditërisht, pas ndryshimit të sistemit në vitin 1990, shumë nga elementet bazë të nevojshëm për krijimin dhe funksionimin e një shoqërie të shëndetshme civile si bashkëpunimi, besimi, partneriteti formal, rrjetet dhe aleancat qytetare, mungonin.

Sfidat e tranzicionit dhe zhvillimit shoqëror dhe ekonomik ishin shumë të mëdha që të adresoheshin në kontekstin e sistemit të ri politik, ekonomisë së varfër, institucioneve të dobta, papunësisë në rritje dhe mentalitetit të një shoqërie e cila kishte qenë e izoluar për 45 vite. Zhvillimi i iniciativave të reja krijoi kushtet për hapjen e shumë sipërmarrjeve private, duke ndikuar në rritjen e ekonomisë dhe zhvillimin e shoqërisë në vend.

⁴ Partnerët Shqiptëri. (2011) Një Vështrim Historik mbi Zhvillimin e Filantropisë në Shqipëri

Krijimi i organizatave jofitimprurëse dhe zhvillimi i shoqërisë civile ishin disa faktorë të tjerë zhvillimi të cilët patën një kontribut në zhvillimin ekonomik dhe social. OJFja e parë shqiptare që u krijua në Dhjetor të vitit 1990 e u regjistrua zyrtarisht në Janar 1991, ishte Forumi për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (sot Komiteti Shqiptar i Helsinkit).⁵

Deri më tani, ende nuk ka një shifër zyrtare të publikuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor të Tiranës, e cila është gjykata kompetente për mbajtjen e Regjistrimit të Organizatave Jofitimprurëse. Është fakt që numri i organizatave aktive në vend, është shumë më i vogël nga numri i organizatave të regjistruara. Në raportin e vlerësimit të nevojave për Shqipërinë, realizuar nga TACSO dhe publikuar në 2011, numri i organizatave të regjistruara zyrtarisht është 2231.⁶ Ndërkaq, Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave (DPPPP) ka publikuar në faqen e saj listën e organizatave të regjistruara pranë organeve tatimore në Republikën e Shqipërisë dhe deri në Qershor 2010 ky numër është 1651 organizata jofitimprurëse.⁷

Kryesisht, veprimtaria e organizatave është e fokusuar në sektorin e ofrimit të shërbimeve, mobilizimin e komuniteteve lokale, mbrojtjen e grupeve në nevojë, transparencën dhe qeverisjen e mirë, ngritjen e kapaciteteve etj.

Puna dhe kontributi i tyre ndër vite, ka një vlerë sociale dhe ekonomike shumë të konsiderueshme, por fatkeqësisht ende të pastudiuar dhe çmuar.

OJFtë luajnë një rol të rëndësishëm në nxitjen e angazhimit qytetar dhe mbrojtjen e interesave të grupeve që përfaqësojnë apo për të cilat ato punojnë. Ndër vite, numërohen disa iniciativa të tyre për mobilizimin e qytetarëve në mbrojtje të çështjeve prioritare me interes publik, si dhe raste të përfshirjes së OJFve aktive në konsultime me qeverinë për hartimin e ligjeve të reja, amendime të ligjeve ekzistues dhe dokumentave strategjikë si: Ligji “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”; Ligji “Për barazinë gjinore në shoqëri”; Ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi”; Strategjia Kombëtare për Personat me Aftësi të Kufizuara 2005-2010; Strategjia Kombëtare për Barazi Gjinore dhe kundër Dhunës në Familje 2007-2010; Strategjia Kombëtare e Luftës Kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore 2008-2010; Strategjia Kombëtare Për Barazinë Gjinore, Dhunën Ndaj Grave dhe Dhunën në Familje 2011-2015; Strategjia Kombëtare e Rinisë dhe Plani Kombëtar i Veprimit 2007-2013 etj.

5 HDPC. Third Sector Development in Albania: Challenges and Opportunities.

6 TACSO. (2011) Needs Assessment Report, Albania

7 DPPPP. www.fint.gov.al/doc/Lista%20e%20OJF%20.xls

Megjithatë, praktika tregon që ende mungojnë mekanizma të konsoliduar, standartë dhe të qëndrueshëm për organizimin dhe funksionimin e konsultimeve të tilla.

Vitet e fundit vërehen disa përpjekje nga ana e Qeverisë për rritjen e bashkëpunimit dhe mbështetjen e sektorit të shoqërisë civile. Në vitin 2009, Parlamenti Shqiptar miratoi ligjin Nr.10 093, datë 9.3.2009 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile”,⁸ me mision nxitjen e zhvillimit të qëndrueshëm të shoqërisë civile dhe krijimin e kushteve të favorshme për nisma civile, në të mirë dhe në interes të publikut. Në vijim, u hartua Karta e Shoqërisë Civile, një angazhim politik që thekson rolin e shoqërisë civile si një partner kyç në zhvillimin e vendit, megjithëse kjo ende nuk është reflektuar në një kuadër ligjor dhe mundësues për sektorin.

Një angazhim tjetër i rëndësishëm i qeverisë shqiptare ishte pjesëmarrja në iniciativën globale “Partneriteti për Qeverisje të Hapur” në vitin 2011.

Si pjesë e planit të veprimit hartuar në kuadër të kësaj iniciative si dhe në Kartën e Shoqërisë Civile të përmendur më lart, shprehet angazhimi i institucioneve qeveritare për krijimin e mekanizmave që mundësojnë rritjen e pjesëmarrjes qytetare në vendimmarrje dhe nxitjen e bashkëpunimit shoqëri civile – qeveri. Mbetet ende shumë punë për t’u bërë në drejtim të zbatimit të kuadrit ligjor dhe angazhimeve të ndërmarra nga ana e Qeverisë, me qëllim që ato të mos mbeten thjesht në letër.

Një rol kyç në nxitjen e institucioneve qeveritare në respekt të zbatimit të ligjit, mbajtjes së angazhimeve dhe thellimit të mëtejshëm të reformave institucionale që nxisin pjesëmarrjen e bashkëpunimin, i takon shoqërisë civile.

⁸ www.amshc.gov.al/web/doc/ligjore/LIGJ_Nr._10093_date_9.3.2009.pdf

5. Korniza Aktuale Ligjore dhe Rregullatore mbi Pjesëmarrjen Qytetare

E drejta e qytetarëve dhe shoqërisë civile për të marrë pjesë në proceset vendimmarrëse nuk është një e drejtë që specifikohet saktësisht dhe shprehimisht nga Kushtetuta e Shqipërisë.

Kjo e drejtë rrjedh nga një sërë parimesh të sistemit politik demokratik të cilat garantohen nga Kushtetuta si: e drejta e lirisë për akses në informacionin publik apo me rëndësi për publikun, e drejta e peticioneve ndaj autoriteteve, e drejta për një mjedis të shëndetshëm, e drejta për të propozuar ligje, e drejta e referendumit, e drejta e lirisë së fjalës dhe grumbullimit e organizimit etj.

Ushtrimi i këtyre të drejtave rregullohet me anë të dispozitave kushtetuese e ligjore, akte ndërkombëtare, rregulloreve e udhëzuesve që sanksionojnë dhe rregullojnë zbatimin e këtyre të drejtave.

Republika e Shqipërisë ka ratifikuar një sërë konventash ndërkombëtare si: Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut; Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore; Pakti Ndërkombëtar mbi të Drejtat Civile dhe Politike; Konventa e UNECE mbi Të drejtën për Informacion, Pjesëmarrjen Publike në Vendimmarrje dhe Të drejtën për t'ju Drejtuar Gjykatës në Çështje Mjedisore (i njohur si Konventa e Aarhusit); Karta Evropiane për Vetëqeverisje Lokale; Konventa e Këshillit të Evropës për Aksesin në Dokumentat Zyrtare; Karta Sociale Evropiane etj.

Këto akte ndërkombëtare garantojnë të drejtën e lirisë së mendimit dhe të shprehjes; të drejtën e lirisë së mbledhjes dhe bashkimit paqësor; të drejtën e organizimit; të drejtën për të marrë pjesë në qeverisjen e vendit, drejtpërdrejt ose me anë të përfaqësuesve të zgjedhur lirisht; të drejtën

për akses në dokumenta zyrtarë; të drejtën për të patur e për të kërkuar informacion në institucionet zyrtare në nivel vendor e qendror; të drejtën për të marrë pjesë në vendimmarrje; të drejtën për t'u ankuar në gjykatë etj.

Sa më lart përbën dhe bazën për të drejtën e organizimit dhe pjesëmarrjes qytetare në vendimmarrje.

Kuadri ligjor në Republikën e Shqipërisë është në linjë me të gjitha aktet e sipërpërmendura dhe në ligjet e rregulloret përcakton garantimin e shumicës së këtyre të drejtave.

Në vijim paraqitet një përmbledhje e kuadrit ligjor dhe rregullator në Republikën e Shqipërisë⁹, që garanton të drejtat e liritë themelore në funksion të pjesëmarrjes në vendimmarrje, mënyrat dhe mekanizmat përkatës.

5.1 Kushtetuta e Shqipërisë

Parime themelore

Neni 2

1. Sovraniteti në Republikën e Shqipërisë i përket popullit.
2. Populli e ushtron sovranitetin nëpërmjet përfaqësuesve të tij ose drejtpërsëdrejti.

Neni 20

1. Personat që u përkasin pakicave kombëtare ushtrojnë në barazi të plotë para ligjit të drejtat dhe liritë e tyre.
2. Ata kanë të drejtë të shprehin lirisht, pa u ndaluar as detyruar, përkatësinë e tyre etnike, kulturore, fetare e gjuhësore. Ata kanë të drejtë t'i ruajnë e zhvillojnë ato, të mësojnë dhe të mësohen në gjuhën e tyre amtare, si dhe të bashkohen në organizata e shoqata për mbrojtjen e interesave dhe të identitetit të tyre.

⁹ Ligji nr. 8789, datë 7.5.2001 "Për Regjistrimin e Organizatave Jofitimprurëse", Ligji Nr.8788, datë 7.5.2001 "Për Organizatat Jofitimprurëse", Ligji Nr.8781, Datë 3.5.2001, "Për Disa Shtesa Dhe Ndryshime Në Ligjin Nr.7850, Datë 29.7.1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë".

Liritë dhe të drejtat vetjake

Neni 22

1. Liria e shprehjes është e garantuar.
2. Liria e shtypit, e radios dhe e televizionit është e garantuar.

Neni 23

1. E drejta e informimit është e garantuar.
2. Kushdo ka të drejtë, në përputhje me ligjin, të marrë informacion për veprimtarinë e organeve shtetërore, si dhe të personave që ushtrojnë funksione shtetërore.
3. Kujtdo i jepet mundësia të ndjekë mbledhjet e organeve të zgjedhura kolektive.

Liritë dhe të drejtat politike

Neni 46

1. Kushdo ka të drejtë të organizohet kolektivisht për çfarëdo qëllimi të ligjshëm.
2. Regjistrimi në gjykatë i organizatave ose i shoqatave bëhet sipas procedurës së parashikuar me ligj.
3. Organizatat ose shoqatat që ndjekin qëllime antikushtetuese janë të ndaluara sipas ligjit.

Neni 47

1. Liria e tubimeve paqësore dhe pa armë, si dhe e pjesëmarrjes në to është e garantuar.
2. Tubimet paqësore në sheshe dhe në vendet e kalimit publik bëhen sipas procedurave të parashikuara me ligj.

Neni 48

Kushdo, vetë ose së bashku me të tjerë, mund t'u drejtojë kërkesa, ankesa ose vërejtje organeve publike, të cilat janë të detyruara të përgjigjen në afatet dhe kushtet e caktuara me ligj.

Liritë dhe të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore

Neni 56

Kushdo ka të drejtë të informohet për gjendjen e mjedisit dhe për mbrojtjen e tij.

Avokati I Popullit

Neni 60

1. Avokati i Popullit mbron të drejtat, liritë dhe interesat e ligjshëm të individit nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike.

2. Avokati i Popullit është i pavarur në ushtrimin e detyrës së tij.

3. Avokati i Popullit ka buxhet të veçantë, të cilin e administron vetë.

Ai e propozon buxhetin sipas ligjit.

Neni 63

3. Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike.

4. Organet dhe funksionarët publikë janë të detyruar t'i paraqesin Avokatit të Popullit të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara prej tij.

Procesi ligjvënës

Neni 81

Të drejtën për të propozuar ligje e ka Këshilli i Ministrave, çdo deputet, si dhe 20 mijë zgjedhës.

Neni 134

1. Gjykata Kushtetuese vihet në lëvizje vetëm me kërkesë të:

ë) Organeve të bashkësive fetare;

f) Partive politike dhe organizatave të tjera;

g) Individëve.

2. Subjektet e parashikuara nga nën - paragrafët dh, e, ë, f dhe g të paragrafit 1 të këtij neni mund të bëjnë kërkesë vetëm për çështje që lidhen me interesat e tyre.

Referendumi

Neni 150

1. Populli, nëpërmjet 50 mijë shtetasve me të drejtë vote, ka të drejtën e referendumit për shfuqizimin e një ligji, si dhe t'i kërkojë Presidentit të Republikës zhvillimin e referendumit për çështje të një rëndësie të veçantë.
2. Kuvendi, me propozimin e jo më pak se një të pestës së deputetëve ose me propozimin e Këshillit të Ministrave, mund të vendosë që një çështje ose një projektligj i një rëndësie të veçantë të shtrohet në referendum.

5.2 Kuadri Ligjor për të Drejtën e Organizimit

E drejta e organizimit, si e drejtë themelore e njeriut e shprehur në mënyrë të qartë edhe në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, rregullohet përmes një sërë ligjesh e rregulloresh të cilat janë hartuar për të garantuar të drejtën e qytetarëve për t'u organizuar në grupime të ndryshme sipas interesave të tyre.

Në vitin 1991 u miratua Ligji Nr. 7516, datë 7.10.1991 "Për Sindikatat në Republikën e Shqipërisë", i cili i përcakton sindikatat si organizata shoqërore që krijohen si bashkime vullnetare të punonjësve për mbrojtjen e të drejtave e të interesave të tyre ekonomike, profesionale e sociale.

Ndërkohë vetëm në vitin 2001, pas një përpjekjeje disa vjeçare shumëpalëshe u miratua paketa ligjore në lidhje me regjistrimin dhe funksionimin e organizatave jofitimprurëse në Shqipëri¹⁰. Disa nga ligjet e nenet kryesore që përcaktojnë objektin dhe funksionimin e kësaj pakete, janë paraqitur si më poshtë.

Më vonë, në vitin 2006 hyri në fuqi Ligji Nr. 9640, datë 9.11.2006 "Për Dhomat e Tregtisë dhe Industrisë". Sipas këtij Ligji, Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë, është person juridik, që nuk ushtron veprimtari fitimprurëse. Objekt i veprimtarisë së saj mes të tjerave është: përfaqësimi dhe mbrojtja e interesave të ligjshëm ekonomikë të anëtarëve të saj; si dhe promovimi dhe realizimi i shërbimeve me interes të përgjithshëm në dobi të anëtarëve të saj.

¹⁰ ECNL. (2011) Raport vlerësues i kuadrit fiskal për shoqërinë civile në Shqipëri (raport i porositur nga Fondacioni i Shoqërisë së Hapur për Shqipërinë)

Ligj Nr.8788, datë 7.5.2001 “Për Organizatat Jofitimprurëse”

Neni 1

Objekti i ligjit

Ky ligj përcakton rregullat për themelimin, regjistrimin, funksionimin, organizimin dhe veprimtarinë e organizatave jofitimprurëse, të cilat ndjekin qëllime në të mirë dhe në interes të publikut.

Neni 4

E drejta e themelimit dhe e pjesëmarrjes

Çdo person fizik ose juridik, vendas ose i huaj, ka të drejtë të themelojë një organizatë jofitimprurëse, të jetë anëtar i saj ose të marrë pjesë në organet drejtuese ose në personelin administrativ të organizatës jofitimprurëse.

Ligj Nr. 8789, datë 7.5.2001

“Për Regjistrimin e Organizatave Jofitimprurëse”

Neni 1

Objekti i ligjit

Ky ligj përcakton procedurat e regjistrimit të organizatave jofitimprurëse, si dhe rregullat për mbajtjen e regjistrit të tyre.

Neni 2

Baza ligjore

Rregullat për formën e organizimit, të themelimit, të veprimtarisë dhe të funksionimit të organizatave jofitimprurëse përcaktohen me ligj.

Neni 3

Regjistrimi

Shoqatat, fondacionet dhe format e tjera të organizatave jofitimprurëse, që mund të ushtrojnë veprimtarinë e tyre dhe fitojnë cilësinë e personit juridik vetëm pas regjistrimit në gjykatë, caktohen shprehimisht me ligj.

“Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë” Miratuar me ligjin nr.7850, datë 29.7.1994, i ndryshuar me ligjin nr. 8781

Pjesë e paketës ligjore për regjistrimin dhe funksionimin e organizatave jofitimprurëse në Shqipëri ishin dhe ndryshimet që u bënë me anë të Ligjit 8781, datë 3.5.2001 në “Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë (miratuar me ligjin nr.7850, datë 29.7.1994). Këto ndryshime u pasqyruan në nenet 39 – 63 të tij.

5.3 Kuadri Ligjor për Mobilizimin e Burimeve dhe Kufizimet Kryesore

Me qëllim që të ekzistojë e të jetë sa më efektiv, angazhimi dhe pjesëmarrja e organizatave të shoqërisë civile në vendimmarrje kërkon një sektor të qëndrueshëm ekonomikisht. Sot, sektori i OJFve në Shqipëri financohet thujtse plotësisht nga donatorët, kryesisht të huaj. Ky sektor merr shumë pak fonde nga burime të cilat në vende të tjera sigurojnë të ardhura domethënëse për OJFtë, si qeveria, filantropia vendore, apo edhe kuotat e anëtarësimit, të ardhurat nga veprimtaria ekonomike si dhe të ardhurat nga shfrytëzimi i pasurisë (aktiveve) në pronësi të vetë organizatës jofitimprurëse.

Megjithëse OJFtë bazuar në legjisllacionin aktual lejohen të kryejnë aktivitet ekonomik (shprehur në nenet 36 dhe 37 të Ligjit Nr.8788), siç ka dalë edhe nga rekomandimet e raportit të vlerësimit të kuadrit ligjor dhe rregullator në Shqipëri, hartuar nga ekspertë të ECNLsë, ka ende konfuzion në dallimin ndërmjet termave jofitimprurëse, fitimprurëse dhe veprimtari ekonomike. Këto terma duhet të përcaktohen qartë në ligj, për të bërë diferencim të qartë ndërmjet veprimtarisë ekonomike dhe veprimtarisë jofitimprurëse si dhe masës se deri në ç’pikë OJFtë lejohen të angazhohen në veprimtari ekonomike. Kjo mund të kërkojë një rishikim të dispozitave përkatëse të Kodit Civil dhe të Ligjit të OJFve.¹¹

¹¹ Ligji nr.7928, datë 27.4.1995 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar”

Në kuadrin ligjor që ndikon në mundësitë e OJFve për të mobilizuar burimet, përveç dispozitave të ligjit aktual të OJFve, një vend shumë të rëndësishëm ze edhe "Ligji për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar".¹² Ky Ligj në nenin 24 të tij, parashikon një përjashtim të veçantë për organizatat jofitimprurëse të cilat ofrojnë shërbime kundrejt një çmimi të reduktuar. Megjithatë, të kualifikuara nën këtë parashikim janë vetëm shërbimet e ofruara nga organizatat fetare apo filozofike për qëllime të mirëqënies shpirtërore, si dhe shërbimet e ofruara nga organizata me status për përfitim publik (siç përcaktohen nga Ministria e Financave).¹³

Siç u përmend më sipër në hyrje të këtij sesi, të ardhurat e organizatave nga shërbimet e ofruara prej tyre me fonde të buxhetit të shtetit, mbeten në nivele shumë të ulta. Megjithëse Ligji nr. 8788 qartazi parashikon në nenin 39 të tij se organizatat jofitimprurëse kanë të drejtë të marrin pjesë në fushën e sipërmarrjes, të tenderimit dhe të prokurimit të granteve, të kontraktimeve dhe të shitblerjeve nga ana e organeve shtetërore të shërbimeve publike, në praktikë ka rezultuar problematik kuadri rregullator dhe procedural i prokurimit të këtyre shërbimeve.

Një tjetër burim mbështetës për sektorin i rregulluar me ligj, është sponsorizimi. Ligji Nr.7892, datë 21.12.1994 "Për Sponsorizimet" (ndryshuar me ligjin nr.8282, datë 21.01.1998; me ligjin nr.9040, datë 27.03.2003 dhe me ligjin nr. 9807, datë 20.09.2007), rregullon mbështetjen me ndihma financiare e materiale, të veprimtarive sociale e publike ku përfshihen veprimtaritë humanitare, kulturore e artistike, sportive, edukative, arsimore, ekologjike dhe vepra letrare, shkencore dhe enciklopedike si dhe të botuesve të shtypit.

¹² Ligji Nr. 10003, Datë 6.10.2008 "Për disa Shtesa e Ndryshime në Ligjin nr.7928, datë 27.4.1995 "Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar", të ndryshuar.

¹³ Ligji Nr.8503, datë 30.6.1999 "Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet Zyrtare"

5.4 Kuadri Ligjor për Lirinë e Shprehjes dhe të Drejtën e Informimit

Shqipëria ofron garanci kushtetuese dhe ligjore të së drejtës së qytetarëve për t'u shprehur dhe informuar.

Katër elementet që aftësojnë përfshirjen qytetare dhe të shoqërisë civile: grupet e organizuara, burimet, informacioni dhe negocimi, varen nga liria e shprehjes dhe e drejta për informim përmes të cilave njerëzit mund të formojnë organizata, mund të mobilizojnë burimet në mënyrë efektive, mund të kërkojnë dhënien e informacionit zyrtar, apo debatojnë me qeveritë në nivel lokal dhe qendror.

Shqipëria ishte i pari vend në rajon që adoptoi legjisllacionin për t'i siguruar qytetarëve të drejtën e informimit dhe aksesit në informacionin zyrtar të paklasifikuar, nëpërmjet miratimit të Ligjit Nr.8503, datë 30.6.1999 "Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet Zyrtare".

Vetëm duke pasur informacionin e duhur dhe të saktë, qytetarët mund të diskutojnë e të kërkojnë llogari mbi aktivitetin e qeverisë së tyre (qendrore apo vendore) dhe shoqëria civile mund të jetë mjaftueshëm e informuar për atë që bëjnë qeveritë dhe zyrtarët e tyre, me qëllim bashkëpunimin, monitorimin dhe vlerësimin e aktivitetit të tyre. Nëse liria e shprehjes është oksigjeni për angazhimin qytetar, e drejta e aksesit në informacion është një ushqyes thelbësor i këtij angazhimi të suksesshëm.

Ligj Nr.8503, datë 30.6.1999 "Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet Zyrtare"

Neni 3 E drejta e informimit

Çdo person ka të drejtë të kërkojë informacion për dokumentet zyrtare, që kanë të bëjnë me veprimtarinë e organeve shtetërore dhe të personave që ushtrojnë funksione shtetërore, pa qenë i detyruar të shpjegojë motivet.

Autoriteti publik është i detyruar të japë çdo informacion në lidhje me një dokument zyrtar, përveç rasteve kur me ligj parashikohet ndryshe.

Çdo informacion për një dokument zyrtar, që i është dhënë një personi, nuk mund t'i refuzohet asnjë personi tjetër që e kërkon atë, me përjashtim të rastit kur ky informacion përbën të dhëna vetjake të vetë personit, të cilit i është dhënë informacioni.

Neni 4 **Kufizimi**

Nëse informacioni i kërkuar për një dokument zyrtar kufizohet me ligj, autoriteti publik i lëshon kërkesit një deklaratë me shkrim, në të cilën tregohen arsyet e mosdhënies së informacionit dhe rregullat në bazë të të cilave ai mund ta kërkojë atë. Nëse kufizimi është vetëm për një pjesë të të dhënave të dokumentit zyrtar, pjesa tjetër nuk i refuzohet kërkesit.

Neni 5 **E drejta e informimit për subjektin me funksione shtetërore**

Çdo person ka të drejtë të informohet për të dhënat vetjake të personave që kryejnë funksione shtetërore ose shërbime publike, të mbajtura në një dokument zyrtar, për aqsa këto të dhëna lidhen me cilësi të kërkuara nga ligji ose nga një akt nënligjor për personat që i ushtrojnë këto detyra.

Neni 6 **Detyrimi për cilësinë e shërbimit të informimit**

Autoriteti publik nxjerr rregullore dhe krijon lehtësi strukturore e praktike për marrjen nga ana e publikut, në mënyrë të saktë, të plotë, të përshtatshme e të shpejtë të informacionit për dokumentet zyrtare.

Neni 7 **Format e dhënies së informacionit**

Kërkesit i vihet në dispozicion një kopje e plotë e dokumentit zyrtar, për të cilin kërkon të informohet. Autoriteti publik, me kërkesë të personit të interesuar ose duke sugjeruar vetë, mund t'i ofrojë kërkesit forma të tjera të dhënies së informacionit, përfshi formën verbale. Në çdo rast të tillë, kërkesi jep me shkrim pëlqimin për formën e ofruar.

Neni 8 **Dokumentet zyrtare që vihen në dispozicion të publikut** **pa kërkesë**

Autoriteti publik është i detyruar të bëjë publike dhe të shumëfishojë vetë, në sasi të mjaftueshme dhe me formate të përshtatshme, dokumente që lehtësojnë informimin e publikut për:

- a) vendndodhjen e organeve qendrore dhe vendore, vendet, si dhe emrat e punonjësve nga të cilët publiku mund të marrë informacion, të paraqesë kërkesa apo të marrë përgjigje;
- b) rregullat, procedurat dhe mënyrat se si mund të merren formularët e ndryshëm, shpjegime për qëllimin dhe përmbajtjen e tyre apo të dokumenteve dhe të vërtetimeve të nevojshme për plotësimin e formularëve;
- c) rregullat e përgjithshme ligjore, sipas të cilave vepron autoriteti publik, politikat e përgjithshme, që zbaton autoriteti publik, si dhe ndryshimet e bëra në to;
- ç) shpjegimet e detajuara për metodat dhe procedurat e punës së autoritetit publik.

Në Nenet 10, 11 dhe 12 të Ligjit, përcaktohen afatet për mospranimin e kërkesës, për dhënien e përgjigjes, për shtyrjen e afateve si dhe të drejtën e ankimit. Autoriteti publik duhet të vendosë nëse do ta pranojë kërkesën për informacion brenda 15 ditëve kalendarike nga momenti i paraqitjes së kësaj kërkesë. Kërkesa duhet të plotësohet brenda 40 ditëve nga depozitimi i saj, me përjashtim të rasteve kur në këtë ligj parashikohet ndryshe. Në rast se autoriteti publik e ka të pamundur plotësimin e kërkesës brenda afatit të parashikuar në nenin 11, për shkak të veçantisë së kërkesës ose të nevojës për t'u këshilluar me një palë të tretë, atëherë ai njofton me shkrim palën e interesuar, jo më vonë se 7 ditë nga mbarimi i afatit të mëparshëm, për pamundësinë e realizimit të pjesshëm ose të plotë të kërkesës për informim, si dhe arsyet apo shkaqet që e kanë sjellë atë.

Në vijim, neni 15 dhe 16 i ligjit parashikon që çdo person ka të drejtë të ankohet, në rrugë administrative, apo/dhe në gjykatë, kur çmon se i janë shkelur të drejtat e parashikuara nga ky ligj. Procedurat e ankimit rregullohen me Ligjin nr.8475, datë 12.5.1999 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë" dhe/ose dispozitat e Kodit të Procedurës Civile.¹⁴

¹⁴ Ligji Nr.8503, datë 30.6.1999 "Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet Zyrtare"

Një tjetër ligj i rëndësishëm që lidhet me të drejtën e informimit është Ligji Nr. 8410, datë 30.9.1998 “Për Radion dhe Televizionin Publik e Privat në Republikën e Shqipërisë”, ndryshuar në vitin 2000 dhe 2003.¹⁵

Mes të tjerash, ligji parashikon parimet themelore të veprimtarisë radiotelevizive në respekt të lirive dhe të drejtave themelore të individit, garanton paanshmërinë në dhënien e informacionit, dhe përcakton qartë mënyrën e transmetimit të mesazheve me dobi shoqërore apo me interes të lartë për publikun e gjerë.

Ligj Nr. 8410, datë 30.9.1998 “Për Radion dhe Televizionin Publik e Privat në Republikën e Shqipërisë”

Neni 4

Parimet themelore të zhvillimit të veprimtarisë radiotelevizive

Veprimtaria radiotelevizive është e lirë.

Veprimtaria radiotelevizive respekton paanshmërisht të drejtën për informacion, bindjet politike e besimet fetare, personalitetin, dinjitetin, jetën private të njeriut, si dhe të drejtat e liritë themelore të tij. Në këtë veprimtari respektohen në mënyrë të veçantë të drejtat, interesat dhe kërkesat morale e ligjore për mbrojtjen e të miturve.

Veprimtaria radiotelevizive nuk lejohet të cënojë rendin kushtetues, sovranitetin dhe integritetin kombëtar.

Neni 36

Programet radiotelevizive publike dhe private respektojnë dinjitetin vetjak dhe të drejtat themelore të njeriut, paanshmërinë, plotësinë dhe pluralizmin e informacionit, të drejtat e fëmijëve dhe të adoleshentëve, rendin publik dhe sigurinë kombëtare, gjuhën dhe kulturën shqiptare, të drejtat kushtetuese e njerëzore të shtetasve, të pakicave kombëtare në përputhje me konventat ndërkombëtare të nënshkruara nga Republika e Shqipërisë, diversitetin fetar shqiptar.

¹⁵ Ligji Nr. 8410, dt 30.9.1998 “Për Radion dhe Televizionin Publik e Privat në Republikën e Shqipërisë”

Neni 39

Informacionet që transmetohen pa shpërblim

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit përcakton me rregullore mesazhet me dobi shoqërore apo me interes të lartë për publikun e gjerë, të cilat rrjetet radiotelevizive publike dhe private detyrohen t'i transmetojnë pa shpërblim. Organet e pushtetit dhe të administratës shtetërore lokale kanë të drejtë t'u kërkojnë të licencuarve për transmetime radiotelevizive lokale private të transmetojnë pa shpërblim komunikata të shkurtra, që paraqesin interes të veçantë për publikun e zonave ku ato transmetojnë dhe që kanë të bëjnë me shëndetësinë, fatkeqësitë natyrore, rendin.

Transmetuesit nuk mbajnë përgjegjësi për përmbajtjen e këtyre mesazheve.

Neni 41

Transmetimi i lajmeve

Radioja dhe televizioni publik e privat në shkallë kombëtare detyrohet të transmetojë çdo ditë lajme.

Lajmet dhe informacionet, që transmetohen nga operatorët radiotelevizivë në edicionet informative, i paraqesin faktet dhe ngjarjet në mënyrë të drejtë e të paanshme, nxisin formimin e lirë të mendimeve dhe nuk i shërbejnë në mënyrë të njëanshme interesave të asnjë partie apo organizate politike, grupimi ekonomik dhe komuniteti a shoqate fetare.

5.5 Ligje dhe Rregullore të Tjera

Në mbështetje të garantimit të të drejtave bazë kushtetuese të sipërpërmendura, si dhe të sigurimit të përfshirjes së qytetarëve në vendimmarrje në nivel vendor e qendror, janë hartuar një sërë ligjesh, rregulloresh dhe udhëzimesh. Ndër më kryesoret të cilat do të paraqiten në vijim janë: "Ligji për Organizimin dhe Funksonimin e Qeverisjes Vendore", i cili përbën dhe bazën kryesore ligjore për pjesëmarrjen e qytetarëve në vendimmarjen lokale; Ligji "Për Organizimin dhe Funksonimin e Ministrisë së Drejtësisë", Ligji "Për Ndhimën dhe Shërbimet Shoqërore", "Ligji për Avokatin e Popullit", "Rregullorja e Punës së Kuvendit të Shqipërisë", "Rregullorja e Punës së Këshillit të Ministrave" si dhe Rregullore të Ministrive.

Ligj Nr.8652, datë 31.7.2000 "Për Organizimin dhe Funkzionimin e Qeverisjes Vendore"

Neni 3

Misioni i pushtetit vendor

Pushteti vendor në Republikën e Shqipërisë siguron qeverisjen në një nivel sa më afër shtetasve nëpërmjet:

- a) njohjes së ekzistencës së identiteteve dhe vlerave të ndryshme të bashkësive;
- b) respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të shtetasve të sanksionuara në Kushtetutë ose në ligje të tjera;
- c) zgjedhjes së llojeve të ndryshme të shërbimeve dhe lehtësirave të tjera publike vendore në dobi të bashkësisë;
- ç) ushtrimit efektiv të funksioneve, kompetencave dhe realizimit të detyrave nga organet e qeverisjes vendore;
- d) realizimit të shërbimeve në forma të përshtatshme;
- dh) nxitjes efektive të pjesëmarrjes së bashkësisë në qeverisjen vendore.

Neni 32

Detyrat dhe kompetencat e këshillit komunal ose bashkiak

Këshilli komunal ose bashkiak ka këto detyra dhe kompetenca (ndër të tjera):

- dh) Miraton buxhetin dhe ndryshimet e tij.
- e) Miraton tjetërsimin ose dhënie në përdorim të pronave të tretëve.
- f) Vendos për taksat e tarifat vendore, si dhe nivelin e tyre.
- k) Miraton norma, standarde e kritere për rregullimin dhe disiplinimin e funksioneve që i janë dhënë atij me ligj, si dhe për mbrojtjen dhe garantimin e interesit publik.

Neni 34

Mbledhjet e hapura

1. Mbledhjet e këshillit janë të hapura për publikun. Çdo qytetar lejohet të ndjekë mbledhjet e këshillit, sipas mënyrës së përcaktuar në rregulloren e këshillit.
2. Njoftimi për mbledhjen e këshillit bëhet publik në vende të caktuara nga këshilli dhe në media. Njoftimi përmban datën, vendin, orën dhe rendin e ditës së mbledhjes.
3. Këshilli, me shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve, vendos për rastet kur mbledhja bëhet e mbyllur.

Neni 35

Seancat e këshillimeve me bashkësinë dhe e drejta e publikut për t'u informuar.

(Shtohet pika 2/1 me ligjin nr.9208, datë 18.3.2004, neni 3)

1. Këshilli komunal ose bashkiak, përpara shqyrtimit dhe miratimit të akteve, zhvillon seanca këshillimi me bashkësinë. Seancat e këshillimit janë të detyrueshme për rastet e parashikuara në nenin 32 shkronjat "dh", "e", "f" dhe "k" të këtij ligji.

2. Këshillimi me bashkësinë, në çdo rast, bëhet sipas mënyrës së përcaktuar në rregulloren e këshillit, duke përdorur një nga format e nevojshme si takimet e hapura me banorët, takime me specialistë, me institucione të interesuara dhe organizata joqeveritare ose nëpërmjet marrjes së nismës për organizimin e referendumeve vendore.

2/1. Për këshillat komunalë/bashkiakë janë të detyrueshme seancat e këshillimit me kryetarët dhe kryesinë e fshatrave nën juridiksion, në përputhje me përcaktimet e bëra në shkronjat "ç", "dh", "e", "f", "k" dhe "ll" të nenit 32 të ligjit. Seancat e këshillimit, në këtë rast, shënohen në procesverbal.

3. Aktet e këshillit afishohen, në vende publike të caktuara nga këshilli, brenda territorit të komunës ose bashkisë dhe, sipas mundësive, këshilli cakton edhe forma të tjera të publikimit të tyre.

Informimi i publikut në çdo komunë e bashki bëhet në përputhje me ligjin nr.8503, datë 30.6.1999 "Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare" dhe rregullat e përcaktuara nga vetë këshilli përkatës për këtë qëllim.

Ligj nr. 8678, datë 14.5.2001" Për Organizimin dhe Funkcionimin e Ministrisë së Drejtësisë

Neni 6

Fusha e veprimtarisë

27. Kujdeset për ndjekjen dhe bashkërendimin e marrëdhënieve me shoqërinë civile për fushën e drejtësisë.

Ligj nr. 9355, datë 10.03.2005 "Për Ndhimën dhe Shërbimet Shoqërore" Ndryshuar me ligjin nr. 9602, datë 28.7.2006

Neni 18

2. Shërbimet e përkujdesit shoqëror publik, që financohen me fondet e buxhetit qendror apo vendor prokurohen nga organet e pushtetit vendor tek ofruesit privatë të tyre, sipas legjislacionit në fuqi për prokurimin publik.

Neni 29

Këshilli i bashkisë/komunës ka këto përgjegjësi:

12. Miraton programe bashkëpunimi me OJF-të, institucionet e kultit dhe përfaqësuesit e shoqërisë civile, në përputhje me planet kombëtare e rajonale të ndihmës dhe shërbimeve të përkujdesit shoqëror.

RREGULLORJA E PUNËS SË KUVENDIT TË SHOQPËRISË ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I KUVENDIT KREU VI. ZHVILLIMI I MBLEDHJEVE TË KOMISIONEVE TË PËRHERSHME

Neni 32

Mbledhjet e komisioneve

4. Në mbledhjet e komisioneve mund të marrin pjesë pa të drejtë vote edhe deputetë **që nuk janë anëtarë të tij, anëtarët e Këshillit të Ministrave, si dhe persona të tjerë të ftuar nga komisioni.**

Neni 35

Publiciteti i mbledhjeve

1. Mbledhjet e komisionit, si rregull, bëhen të hapura. Mbledhja quhet e hapur kur media, grupet e interesit ose vizitorët janë të lejuar ta ndjekin atë.

Neni 36

Seancat dëgjimore publike

1. Komisioni mund të organizojë seanca dëgjimore publike me anëtarë të Këshillit të Ministrave, përfaqësues të lartë të institucioneve shtetërore ose publike, ekspertë, përfaqësues të shoqërisë civile, përfaqësues të grupeve të interesit, si dhe grupime të tjera të interesuara. Komisioni është i detyruar të realizojë seancën dëgjimore, sipas përcaktimeve të bëra në këtë nen, në rast se një e treta e të gjithë anëtarëve të komisionit e kërkon atë në mënyrë të motivuar me shkrim.

KREU VII. ZHVILLIMI I SEANCAVE PLENARE

Neni 43

Publiciteti i seancave plenare

1. Seancat plenare të Kuvendit bëhen të hapura, me përjashtim të rastit kur Kuvendi vendos ndryshe.

Neni 54

Regjistrimi dhe publikimi i diskutimeve

1. Në seancat plenare të Kuvendit mbahen proceverbale të përmbledhura, si dhe bëhet regjistrimi i plotë i tyre. Në procesverbalin e përmbledhur shënohet data e zhvillimit të seancës plenare dhe rendi i ditës së saj, pjesëmarrja e deputetëve, përmbledhja e diskutimeve dhe e qëndrimeve të mbajtura nga deputetët, si dhe rezultatet e votimit. Çdokush ka të drejtë të njihet me përmbajtjen e procesverbaleve të Kuvendit para botimit. Procesverbalet publikohen në faqen e internetit të Kuvendit.

PROCEDURA LIGJVËNËSE

KREU I. NISMA LIGJVËNËSE

Neni 68

Propozimi i ligjeve

1. E drejta për të propozuar ligje i takon Këshillit të Ministrave, çdo deputeti dhe 20 mijë zgjedhësve.

Neni 69

Shpërndarja e projektligjeve

2. Kryetari i Kuvendit urdhëron menjëherë shpërndarjen e tyre deputetëve. Kopje të projektligjeve u vihen në dispozicion, me kërkesën e tyre, medias ose personave të tjerë.

KREU II. SHQYRTIMI I PROJEKTLIGJIT TË BUXHETIT TË SHTETIT DHE I PROJEKTLIGJEVE FINANCIARE

Neni 80

Shqyrtimi në komisione

2. Komisionet e Kuvendit mund të organizojnë seanca dëgjimore publike me qëllim marrjen e vërejtjeve dhe mendimeve nga institucione, persona ose grupe të interesuara për projektligjin e Buxhetit të Shtetit dhe projektligjet financiare që kanë lidhje të drejtpërdrejtë me të.

KREU III. DISPOZITA TË TJERA PËR KONTROLLIN NGA KUVENDI

Neni 104 Peticionet

1. Peticionet, të cilat i drejtohen Kuvendit, shqyrtohen nga komisionet e përhershme përkatëse.
2. Pranohen për shqyrtim peticionet, të cilat janë bërë me shkrim, kanë emrin e dërguesit dhe nënshkrimet përkatëse, janë të kuptueshme dhe tregojnë qartë objektin e tyre.
3. Peticionet dërgohen nga Kryetari i Kuvendit në komisionin e përhershëm që ka lidhje me objektin e paraqitur në peticion. Kryetari komisionit mund t'ia kthejë peticionin dërguesve për rihartim ose t'u kërkojë atyre sqarime shtesë.
4. Jo më vonë se 45 ditë nga data e marrjes së peticionit, kryetari i komisionit e paraqet peticionin në komision, duke propozuar njëkohësisht edhe mënyrën e zgjidhjes ligjore ose mospranimin e peticionit. Në rast se komisioni e gjykon të arsyeshme për zgjidhjen e çështjes, mund të autorizojë kryetarin e komisionit për të paraqitur një deklaratë në seancën plenare të Kuvendit. Hapat e ndërmarrë dhe zgjidhja e çështjes së ngritur në peticion i njoftohen dërguesve të peticionit.

TRANSPARENCA E VEPRIMTARISË SË KUVENDIT

Neni 105 Veprimtaria e hapur e Kuvendit

1. Veprimtaria e Kuvendit është e hapur, me përjashtim të rastit të parashikuar në nenin 43 të kësaj Rregulloreje.
2. Veprimtaria e hapur e Kuvendit realizohet nëpërmjet:
 - a) pjesëmarrjes së publikut në procesin ligjvënës;
 - b) pasqyrimin të veprimtarisë së Kuvendit dhe organeve të tij në median e shkruar dhe vizive;
 - c) botimeve të dokumentacionit parlamentar;
 - ç) faqes së internetit të Kuvendit;
 - d) rrjetit të brendshëm audiovizual.

Neni 106 Dokumentacioni parlamentar

2. Dokumentacioni parlamentar është i hapur për publikun.

RREGULLORE E KËSHILLIT TË MINISTRAVE
(miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave
Nr. 584, Datë 28.8.2003 "Për Miratimin e Rregullores
së Këshillit të Ministrave")

Pika 14

"Projektaktet hartohen nën përgjegjësinë e strukturës juridike, e cila në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse dhe ato të fushave përkatëse të ministrisë, organizon këshillime me drejtues a specialistë të drejtorive, sektorëve a enteve, si dhe me struktura të shoqërisë civile, veprimtaria e të cilave lidhet me objektin, qëllimin dhe zbatimin e projektaktit".

RREGULLORE E BRENDSHME

"Për Organizimin dhe Funkcionimin e Ministrisë së
Punës Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta"
(Miratuar me Urdhrin nr.1360, datë 15.06.2010 të
MPÇSSH)

KREU III. SHËRBIMI CIVIL

Neni 10

Drejtoria e Politikave të Shërbimeve Sociale

2. Programon dhe ndjek delegimin e fondeve për institucionet e decentralizuara të shërbimeve sociale pranë pushtetit vendor dhe nxit përfshirjen e shoqërisë civile në ofrimin e shërbimeve.

Neni 21

Drejtoria e Monitorimit të Strategjive Ndersektoriale

5. Ngritja dhe forcimi i rrjetit të pikave të kontaktit në nivel qendror dhe vendor si dhe me shoqëri të civilë, ndërtimi i bashkëpunimit me të gjithë aktorët, me qëllim ndjekjen e zbatimit të objektivave të Strategjive Kombëtare Ndersektoriale sipas planeve të veprimit.

KREU IV. RREGULLA DHE PROCEDURA

Neni 24

Procedura e hartimit të projektakteve

II. Përgatitja e projektakteve ligjore dhe nënligjore

Gjatë përgatitjes së projektakteve Drejtoritë e linjës në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimeve Juridike, gjykojnë nëse është e nevojshme që të merren mendime nga eksperte brenda ose jashtë ministrise apo struktura të shoqërisë civile, veprimtaria e të cileve lidhet me objektin, qëllimin dhe zbatimin e projektaktit.

RREGULLORE E BRENDSHME

“Për Organizimin dhe Funkzionimin e Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave”

I. DREJTORIA E PËRGJITHËSHME E POLITIKAVE (DPP)

I/10. Specialisti i ekstensionit:

Merr iniciativa për ndërgjegjësimin e publikut për pjesëmarrjen sa më të gjerë të komunitetit në menaxhimin e burimeve natyrore, mjedisit etj;

m) Përgatit programe dhe paketa për komunikimin, për marrëdhëniet me publikun, shërbimin këshillimor për pylltarinë komunale dhe private për grupe të caktuara të popullatës;

o) Merr iniciativa për ndërgjegjësimin e publikut për pjesëmarrjen sa më të gjerë të komunitetit në menaxhimin e burimeve natyrore, mjedisit etj;

p) Bashkëpunon dhe mban lidhje me OJQtë vendase e të huaja që operojnë në pyje dhe kullota komunale;

III. DREJTORIA E BIODIVERSITETIT

III/3. Përgjegjësi i Sektorit :

Drejton dhe merr pjesë aktive në përmirësimin e politikave dhe legjislacionit duke përafuar me legjislacionin Evropian, përvojën e vëndeve Europiane, nëpërmjet përfshirjes të grupeve të interesit.

VIII/5. Sektori i informimit të publikut dhe ITsë; Përgjegjës sektori

b) Siguron komunikimin me publikun dhe shoqërinë civile dhe merr masat për pjesëmarrjen e tyre aktive në veprimtaritë e ministrisë.

f) Ndjek procedurat e konventës së Aarhusit (Konventa për të drejtën e informimit të publikut në vendimarrje dhe të drejtën për t'ju drejtuar gjykatës për problemet mjedisore) si dhe ndjek zbatimin e detyrave në kuadër të saj.

g) Ndjek dhe përgjigjet për mirëmbajtjen dhe përditësimin e informacionit në Websit-in e ministrisë.

h) Ndjek dhe administron informacionin lidhur me kërkesat e publikut dhe mban lidhje me drejtoritë përkatëse për këtë qëllim.

i) Mban regjistrin elektronik të kërkesës së ankesave të publikut.

VIII/6. Specialisti për informimin e publikut

Ndihmon në rritjen e pjesëmarrjes aktive të subjekteve, OJFve dhe publikut për mbrojtjen e mjedisit në zonat ku ata jetojnë dhe ushtrojnë veprimtaritë.

6. Analiza e Gjetjeve të Vrojtimit mbi Angazhimin e Shoqërisë Civile në Proceset Vendimmarrëse

Ky vrojtim u krye gjatë vitit 2012 në 10 bashkitë kryesore në vend. Instrumenti kryesor i vrojtimit ishte një pyetësor standard. Përveç informacionit të përgjithshëm mbi formën e organizimit, misionin dhe fokusin kryesor të aktiviteteve të OJFve, pyetjet i referoheshin përvojës mbi a) aksesin në informacion publik nga zyrat e pushtetit vendor, format e aplikimit, praktikat e mira, kritika e sugjerime; b) dijenisë për kuadrin ligjor rregullator mbi të drejtën e informimit dhe c) partneritetit OJF-Pushtet Vendor dhe OJF-OJF.


Përpara administrimit të pyetësorit, PSh u dërgoi kërkesë për pjesëmarrje në vrojtim, një numri të madh organizatash në të gjithë vendit. Në bazë të gatishmërisë e dëshirës për t'u shprehur mbi çështjet që studimi trajton, kampioni i vrojtimit ishte 100 organizata. Nga 100 pyetësorë, 95 rezultuan të vlefshëm për analizën e të dhënave.

Në mbështetje të të dhënave të siguruar nga pyetësori, PSh zhvilloi dhe një seri me intervista dhe grupe të fokusuar për një informacion më të thelluar mbi praktikat, sfidat dhe rezultatet konkrete të punës së tyre në drejtim të pjesëmarrjes qytetare në proceset vendimmarrëse.

Duhet theksuar fakti që organizatat të cilat me opinionet e tyre u bënë pjesë e këtij studimi, janë ndër më aktivet e me një eksperiencë të konsiderueshme në zbatimet projektesh, bashkëpunime me pushtetin vendor e qendror, dhe mobilizim qytetar.


6.1 Analiza e Kampionit

Grafik 1. Harta e shpërndarjes së kampionit




Në Grafikon 1 paraqitet shpërndarja gjeografike e organizatave pjesëmarrëse në studim.

Grafik 2. Forma e regjistrimit të organizatave brenda kampionit




Në përgjigje të pyetjes mbi formën e regjistrimit dhe funksionimit të organizatës së tyre bazuar në legjislacionin në fuqi, 58% e pjesëmarrësve në studim kanë deklaruar Shoqatë, 29% Qendër dhe 13% Fondacion.

Grafik 3. Fushat e veprimtarisë së organizatave të kampionit




Bazuar në deklaratimet e OJFve, më sipër paraqiten fushat e veprimtarisë së organizatave pjesëmarrëse bazuar në aktivitetet kryesore të sanksionuara në misionet e statutet e tyre.

Grafiku 4. Aktiviteti kryesor i organizatave sipas formës së regjistrimit



Sikurse pasqyrohet në Grafikon 4, aktiviteti kryesor i organizatave të kampionit është ofrimi i shërbimeve dhe mobilizimi i komunitetit, si dhe ndërtimi i kapaciteteve për OJF të tjera, pushtetin vendor e biznesin. Ndërkohë, 23 organizata ose 24% e kampionit e kanë të cilësuar ndër aktivitetet kryesore në statutin e tyre monitorimin e pushtetit vendor. Më pak organizata, 20 % e kampionit, shprehen që kanë influencimin e politikave lokale.

Grafiku 5. Numri i projekteve të organizatave gjatë 2011 - 2012



Gjatë vitit 2011-2012, 23% e organizatave deklarojnë që nuk kanë patur projekte në zbatim. Në përgjithësi të gjitha organizatat pjesëmarrëse në studim, e në veçanti organizatat relativisht të reja, shprehen se kanë vështirësi në sigurimin e fondeve. Reduktimi i fondeve dhe largimi i disa donatorëve strategjikë apo mbyllja e disa programeve ka ndikuar në këtë drejtim.

Gjithashtu, këto vështirësi lidhen edhe me mungesën e kapaciteteve të këtyre organizatave për hartimin e projekteve cilësore e në përputhje me kërkesat e donatorëve.

6.2 Aksesimi në informacione dhe dokumente publike dhe marrëdhëniet me publikun

Qeverisja vendore është forma e qeverisjes më pranë qytetarëve, që krijon, mban dhe menaxhon marrëdhëniet më të afërta me ta. Bazuar në këtë filozofi, pushteti vendor duhet t'i kushtojë rëndësi të veçantë dhe të ketë në prioritetet e veta marrëdhëniet me publikun.

Për t'i shërbyer këtij qëllimi, në shumë nga njësitë e qeverisjes vendore janë krijuar Zyrat e Informimit Qytetar (ose Zyrat me Një Ndalesë) si praktikë për t'u shërbyer qytetarëve në kohë dhe me cilësi. ZIQ janë urat e para që lidhin NJQVtë dhe zyrtarët e tyre me qytetarët dhe të gjitha format e organizimit qytetar përfshirë këtu edhe OJFtë.


Zyrat e Informimit Qytetar janë krijuar në bazë të Ligjit 8503, “Mbi të Drejtën e Informimit mbi Dokumentet Zyrtare”, për t’u siguruar qytetarëve të drejtën e informimit. Misioni i këtyre zyrave përveç informimit në lidhje me aktivitetin e NJQVve, është edhe të mbledhë shqetësimet e qytetarëve, ankesat dhe kërkesat për informacion, si dhe t’u përgjigjet atyre brenda afateve kohorë të parashikuar me ligj.

Neni 23/2 i Ligjit 8503 citon se “çdokush ka të drejtën, në përputhje me ligjin, të informohet mbi aktivitetin e organeve shtetërore, si dhe të personave që mbajnë funksione shtetërore”.

Jo në të gjitha NJQVtë, janë ngritur dhe funksionojnë ZIQ. Arsyet kryesore të mos ekzistencës së tyre përfshijnë mungesën e fondeve për krijimin e mjediseve të përshtatshme fizike, mungesën e sistemeve teknologjike, mungesën e burimeve dhe kapaciteteve njerëzore për të shërbyer në këto zyra, si dhe mungesën e vullnetit politik për të vënë në funksion edhe investimet ekzistuese që janë kryer në këtë drejtim.

Analiza dhe grafikët e mëposhtëm pasqyrojnë perceptimet dhe përvojat e organizatave mbi aksesin në informacion që NJQVtë ofrojnë, nivelin e kënaqësisë në lidhje me shërbimet e marra, si dhe konsideratat e tyre mbi Zyrat e Informimit Qytetar në ato NJQV ku këto zyra ekzistojnë (kjo përfshin 81% të kampionit).

Grafik 6. Përqindja e organizatave që kanë kërkuar informacion gjatë vitit 2011 – 2012, sipas formës së regjistrimit




Gjatë kësaj periudhe, 71 organizata kishin dërguar të paktën një kërkesë për informacion publik në Bashkinë e tyre, për arsye të ndryshme lidhur me aktivitetin e tyre apo nevoja të grupeve të cilave u shërbejnë. Nga Grafiku 6 vërehet se shoqatat, janë ato që më shpesh drejtohen për të marrë informacion nga qeveria vendore.

Informacioni në NJQV është kërkuar përmes njëres nga format e poshtëshënuara:

- Kërkesë me shkrim;
- Duke u paraqitur fizikisht në Zyrën e Informacionit;
- Kërkesë për informacion me telefon/faks;
- Kërkesë për informacion me E-mail.
-


Nga deklaratimet e organizatave, forma mbizotëruese e kërkimit të informacionit, ankimimit etj, mbetet paraqitja fizike në ZIQ dhe kërkesat me shkrim.

Grafiku 7. Rastet e marrjes së dokumentave të kërkuara




Të pyetur mbi rastet e marrjes së përgjigjes së kërkesës për informacion, ankimimit, etj, organizatat që kishin kërkuar të paktën një herë informacion shprehen si më sipër.

Grafiku 8. Koha e marrjes së përgjigjes të kërkesës për informacion/ dokumente



Në lidhje me kohën e marrjes së përgjigjeve në përputhje me afatet e përcaktuara në Ligjin Nr.8503, datë 30.6.1999 “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet Zyrtare”, përvoja e organizatave rezulton si më sipër.

Grafik 9. Arsyet përse nuk kanë kërkuar akses në dokumentet e pushtetit vendor




65% e organizatave që kanë aplikuar për informacion pranë NJQVve përkatëse dhe kanë marrë përgjigje për çdo rast, shprehen se koha e marrjes së përgjigjeve është e kënaqshme e në përputhje me afatet në të cilat ishte rënë dakord mes palëve. Ndërkohë, 10% e organizatave shprehen se nuk kanë marrë përgjigje në asnjë formë për kërkesat e tyre edhe pse ligji

parashikon detyrimin e NJQVve për t'iu përgjigjur kërkesave për informacion publik, brenda një afati kohor nga 15 deri 40 ditë pune.


Megjithë panoramën relativisht pozitive mbi zbatimin e afateve, organizatat shprehen se mbetet ende shumë për t'u bërë në kuadër të përmirësimit të shërbimit dhe etikës së komunikimit në shumicën prej bashkive të përfshira në studim.

27% e kampionit nuk kanë kërkuar akses në dokumentet e qeverisë vendore. Arsyet e këtij qëndrimi pasqyrohen në Grafikon 9.

Grafik 10. Ndikimi i ZIQ në përmirësimin e aksesit në informacion




Grafik 11. Drejtimet kryesore të përmirësimit të aksesit në informacion që nga hapja e ZIQ



Bazuar në përvojën dhe deklarin e 61% të organizatave të kampionit (shih Grafikon 10), aksesin publik në informacionet e qeverisë vendore është përmirësuar me hapjen e ZIQ. Ky përmirësim shprehet veçanërisht në drejtim të etikës së komunikimit dhe lehtësisë të procedurave të arkivimit dhe përgjigjes së kërkesave për informacion. Megjithatë, në drejtim të shkurtimeve të afateve të dhënies së këtyre përgjigjeve si dhe komunikimit më ndërveprues përmes teknologjive të informacionit (e-mail, website etj) mbetet ende punë për t'u bërë (Grafiku 11).


Grafik 12. Problematika kryesore e identifikuar nga OJFtë lidhur me aksesin në informacion që nga hapja e ZIQ



13% e organizatave që kanë patur përvojë të kërkimit të informacionit në ZIQ janë të mendimit se shërbimi në zyrat në fjalë nuk është përmirësuar, dhe qëndrimet e tyre pasqyrohen më lart në Grafikon 12.

Përveç ZIQ, një kanal tjetër i rëndësishëm komunikimi me qytetarët, është faqja e internetit të NJQVve dhe komunikimi elektronik. Në ditët e sotme gjithnjë e më shumë shërbime publike në nivel qendror dhe lokal janë dixhitalizuar dhe janë të arritshme nga publiku nëpërmjet faqeve zyrtare të NJQVve, të cilat duhet të jenë të përditësuara dhe lehtësisht të përdorshme nga publiku. Jo të gjitha bashkitë e vendit (e aq më pak komunat) kanë një faqe zyrtare aktive. Edhe në një pjesë të mirë të atyre që e kanë, aksesin e cilësia e informacionit online në dispozicion të publikut le shumë vend për t'u përmirësuar.


Grafik 13. Relevanca e dokumenteve zyrtare online në faqen e internetit të njësisë së pushtetit vendor



Nga 10 bashkitë në të cilat ushtrojnë aktivitetin organizatat pjesëmarrëse në studim, 72% shprehen se faqet zyrtare të bashkive të tyre ekzistojnë, por kanë pak informacion të dobishëm për publikun si edhe për nevojat e organizatave.

Në shumicën e rasteve informacionet në këto faqe nuk janë të përditësuara me njoftime për çështje të ndryshme, njoftime mbi datat e mbledhjeve të këshillave bashkiakë dhe vendime të këshillit (detyrim ligjor për t'i bërë publike) etj. Ka ende NJQV të cilat nuk kanë përditësuar informacionin mbi leadershipin e zgjedhur në faqet e tyre të internetit.

Grafik 14. Veprimet që duhet të ndërmerret pushteti vendor për të nxitur më shumë akses të publikut në informacion




Në Grafikun 14 paraqiten sugjerimet e organizatave mbi masat që pushteti vendor duhet të ndërmarrë për të nxitur më shumë aksesin e publikut në informacion e për të përmbushur kriteret që parashikon ligji për të drejtën e informimit.

6.3 Bashkëpunimi Ndërmjet Organizatave të Shoqërisë Civile dhe Pushtetit Vendor

Bashkëpunimi midis organizatave të shoqërisë civile dhe pushtetit vendor ishte një nga aspektet kryesore të studimit, i matur në disa dimensione si: niveli i njohurive të OJFve mbi Ligjin për Funkzionimin e Qeverisjes Vendore; format e bashkëpunimit OJF-PV; partneriteti në projekte e iniciativa; pjesëmarrja e OJFve në forume publike lokale si dhe pengesat në kuadër të bashkëpunimit OJF-PV.


Grafik 15. Njohuritë e organizatave mbi përmbajtjen e Ligjit për Funkzionimin e Qeverisjes Vendore



25% e organizatave deklarojnë se kanë shumë informacion mbi Ligjin Nr.8652, datë 31.7.2000 “Për Organizimin dhe Funkzionimin e Qeverisjes Vendore”, përkundrejt 9% që shprehen se nuk kanë aspak njohuri mbi këtë ligj dhe gjithë hapësirat që krijon ai për marrjen e informacionit nga pushteti vendor dhe monitorimin e aktivitetit të tij. Megjithëse 66% e kampionit shprehet se ka njohuri mbi ligjin në fjalë, kjo njohuri varion nga dijenia për ekzistencën e këtij ligji e deri në njohuri për aspekte të veçanta të tij që rregullojnë marrëdhënien me qytetarët dhe ofrimin e shërbimeve.

Kjo u konstatua në diskutimet e thelluara në grupe të fokusuara të zhvilluara nga PSh në tetë qytetet kryesore në vend.

Grafik 16. Qëndrimi i pushtetit vendor kundrejt OJFve



Grafiku 16 më lart paraqet perceptime të organizatave pjesëmarrëse në studim mbi qëndrimin e pushtetit vendor ndaj OJFve përkundrejt katër aspekteve orientuese madhore.


Projekte të përbashkëta dhe bashkëpunimi OJF–PV

71 organizata deklarojnë të kenë patur të paktën një projekt të përbashkët me NJQVtë ku ushtrojnë aktivitetin e tyre dhe japin komente mbi përvojat e këtyre bashkëpunimeve, qofshin ato pozitive apo negative. Pothuajse në të gjitha rastet, ky bashkëpunim ka qenë i kërkuar nga organizatat.

Bashkëpunimet më të zakonshme referohet të kenë qenë dhënia e mjediseve publike për përdorim gjatë aktiviteteve, dhënia e zyrave pa pagesë në ndërtesa në pronësi të NJQVve, dhe shumë pak raste të financimit të aktiviteteve nga ana e tyre. Kjo është një nga pengesat më të mëdha që vështirëson bashkëpunimin e dyanshëm OJF - PV.


Disa nga Organizatat përmendin praktikatat e buxhetimit me pjesëmarrje si një prej aktiviteteve gjatë të cilave kanë punuar ngushtë me pushtetin vendor, si edhe pjesëmarrjen në përpilimin e strategjive vendore të zhvillimit.

Grafik 17. Vlerësimi i partneritetit të OJFve me pushtetin vendor




Ndër organizatat që kanë patur bashkëpunime me pushtetin vendor, vetëm 10% e tyre shprehen që e kanë patur shumë të lehtë këtë bashkëpunim, ndërkohë që 37% ndajnë përshtypjen e përbashkët se të punosh me pushtetin vendor nuk është aspak e lehtë. Në shume raste ka mungesë të vullnetit të stafeve të NJQVve për t'u përfshirë realisht në bashkëpunime e projekte të përbashkëta.

Grafik 18. Arsyet e mungesës së bashkëpunimit në projekte me pushtetin vendor



Ato organizata që nuk kanë patur partneritet me qeverinë vendore përkatëse, shprehen si më sipër, mbi arsyet e mungesës së kësaj praktike.

Grafik 19. Pengesat në zbatimin e projekteve me pushtetin vendor




Burimet financiare mbeten pengesa kryesore në zbatimin e projekteve nga organizatat e kampionit në nivel vendor. Rastet e financimit të projekteve apo aktiviteteve të OJFve nga pushteti vendor, siç shprehen vetë organizatat janë të rralla dhe në shuma të vogla.

Pjesëmarrja e OJFve në mbledhjet e këshillit bashkiak dhe forume publike


Sikurse citohet edhe më lart në këtë studim, OJFtë janë një hallkë shumë e rëndësishme që lidh qytetarët me pushtetin vendor. Pavarësisht opinioneve dhe sugjerimeve që organizatat japin lidhur me nevojën për bashkëpunim dhe përmirësimin e komunikimit me NJQVtë përkatëse, ka një tregues mjaft të ulët të prezencës së tyre në monitorimin e aktiviteteve të bashkisë apo mbledhjet e këshillit bashkiak, si një ndër format e pjesëmarrjes direkte në vendimmarrjen lokale.

Grafik 20. Pjesëmarrja në forume publike gjatë 2011-2012




Lidhur me pjesëmarrjen e tyre në forume publike gjatë vitit 2011-2012, organizatat shprehen si në Grafikon 20. Pjesëmarrja më e madhe e OJFve vërehet në forumet publike si takime e diskutime mes aktorëve e grupeve të interesit në nivel lokal, seminare, workshope, mbledhje në komunitet e institucione etj.

Grafik 21. Efektiviteti i forumeve publike




Grafik 22. Rezultatet e pjesëmarrjes së OJFve në forume publike



Ato organizata që i kanë vlerësuar nga “Disi efektive” deri në “Shumë efektive”, kanë vijuar monitorimin pas forumeve publike dhe i kanë parë rezultatet e tyre të pasqyruara në aktivitetet e sipërpërmendura.

Grafik 23. Frekuenca e pjesëmarrjes në mbledhje të këshillave bashkiakë



Të pyetur mbi pjesëmarrjen në mbledhjet e këshillave bashkiakë, si një ndër format e monitorimit të pushtetit vendor dhe veprimtarisë së tij, vetëm 12% e OJFve ka monitoruar rregullisht këto mbledhje.

Në Grafikon 23 duket qartë se pjesa më e madhe e organizatave marrin pjesë në monitorimin e mbledhjeve të këshillave bashkiakë, vetëm në rastet kur


kanë projekte në zbatim lidhur me këtë çështje, e jo si pjesë e qëndrueshme e aktivitetit të tyre.

Nga diskutimet në grupet e fokusuara, OJFtë pranojnë se duhet të jenë më prezente dhe të marrin pjesë më shpesh në çdo mbledhje të këshillit bashkiak që trajton çështje në interes të komunitetit, e jo vetëm të atyre grupeve interesat e të cilave përfaqësojnë.


6.4 Partneriteti OJF – OJF

Për të vlerësuar frymën e bashkëpunimit edhe midis vetë sektorit, një ndër çështjet në fokus në studim ishte vlerësimi i partneritetit ndërmjet organizatave të shoqërisë civile dhe zbatimi i nismave dhe projekteve të përbashkëta. 87% e organizatave pjesëmarrëse në studim, kanë zbatuar në të kaluarën dhe aktualisht projekte në partneritet me organizata të tjera. Pavarësisht numrit të projekteve të zbatuara, partneriteti vlerësohet efektiv (Grafik 24).


Grafik 24. Efektiviteti i partneritetit ndërmjet OJFve përkundrejt numrit të projekteve



Grafik 25. Nevojat për arritjen e partneriteteve më të efektshme brenda sektorit



Grafik 26. Nevojat në arritjen e partneriteteve më të efektshme sipas qyteteve



Siç organizatat deklarojnë (Grafikun 25), pushteti vendor duhet të luajë një rol më të madh në inkurajimin e projekteve të organizatave dhe financimin e iniciativave në partneritet, për një zhvillim më të qëndrueshëm në nivel lokal. Kjo është konstatuar si nevojë kryesore për arritjen e partneriteteve më të efektshme brenda sektorit nga të gjitha organizatat, pavarësisht rajonit ku ushtrojnë aktivitetin e tyre.

Sa i përket nevojave të tjera, edhe pse sektori është krijuar dhe funksionon prej më shumë se 20 vitesh, rritja e kapaciteteve të tij dhe ofrimi i asistencës teknike, mbeten nevoja të vazhdueshme që duhet të adresohen.

7. Përfundime dhe Rekomandime

Rekomandimet e mëposhtme synojnë të japin ide dhe sugjerime për fushat e ndërhyrjes dhe masat që duhet të ndërmerren për garantimin dhe rritjen e pjesëmarrjes së qytetarëve dhe OJFve në vendimmarrje.

- **Rritja e transparencës së NJQVve mbi veprimtarinë e tyre dhe përmirësimi i komunikimit mes pushtetit vendor dhe OJFve e qytetarëve.** Nga referimet e organizatave të përfshira në studim, del një qëndrim i përbashkët që thekson se mungesa e korrektesisë dhe transparencës ndaj publikut, në lidhje me përfshirjen në proceset vendimmarrëse apo dhe për të pasqyruar vetë punën e NJQVve mbetet problematike. NJQVtë nuk përdorin në mënyrë të vazhdueshme kanalet e komunikimit me publikun. Mjetet e mënyrat e parashikuara me ligj, nuk aplikohen sipas këtyre parashikimeve. Komunikimi u identifikua nga OJFtë si një ndër faktorët kryesorë në krijimin dhe mbajtjen e marrëdhënies mes pushtetit qendror e sidomos atij vendor dhe OJFve e qytetarëve, në funksion të garantimit të qeverisjes së mirë dhe efektive, si dhe transparencës. Në këtë drejtim ka një sërë nevojash që duhen adresuar. Shtimi i kanaleve të komunikimit dhe përdorimi efektiv i tyre (veçanërisht komunikimi elektronik përmes e-mail, faqe interneti, media sociale etj.), dixhitalizimi i sistemeve të informacionit në NJQV dhe institucione në nivel qendror, përdorimi i medias së shkruar dhe vizive lokale për transmetimin e informacioneve me interes publik (njoftime, thirrje interesi etj.) janë disa nga masat që duhen marrë për përmirësimin e gjendjes në këtë drejtim.

- **Zbatim rigoroz i kuadrit ligjor ekzistues dhe krijimi i mekanizmave të qëndrueshëm ligjorë e institucionalë për garantimin e pjesëmarrjes qytetare në nivel vendor dhe qendror.** Megjithëse disa OJF deklaruan gjatë vrojtimit pjesëmarrjen e tyre në procese konsultuese me qeverinë, këto raste mbeten sporadike, jo të qëndrueshme e sipas standarteve, dhe në përputhje me preferenca personale a partiake të institucioneve qeverisëse. Shumë pak ministri e NJQV e kanë të përcaktuar në rregulloret e brendshme përfshirjen e qytetarëve apo grupeve të interesit në politikëbërje apo marrje vendimesh, ndërkohë që edhe kur është e përcaktuar, format e mënyrat e përfshirjes mbeten evazive e në varësi të gjykimit të institucioneve qeverisëse. Është e nevojshme që të bëhen specifikime të mëtejshme, përmes akteve nënligjore apo detyrimit për zbërthimin e tyre sa më qartë në udhëzime, rregullore a procedura. Vendosja e standarteve dhe transparencës do të rriste besimin e qytetarëve në institucione dhe përfshirjen e tyre, duke bashkuar kështu më shumë kontribute për zhvillimin e komunitetit.
- **Krijimi i strukturave (njësi koordinuese, person përgjegjës për marrëdhëniet me OJFtë etj) për lehtësimin e praktikave të bashkëpunimit mes sektorit të OJFve dhe pushtetit qendror e vendor.** Nga studimi konstatohet mungesa e strukturave dhe hallkave funksionale për komunikimin e drejtpërdrejtë, koordinimin dhe përfshirjen e OJFve në vendimmarrje e ofrim shërbimesh. Vetëm vitet e fundit pak ministri e bashki, kanë caktuar persona përgjegjës, pjesë e stafeve të tyre, që kanë mes të tjerash edhe rolin për informim apo koordinim me OJFtë.
- **Fuqizimi i kapaciteteve të burimeve njerëzore të NJQVve në drejtim të përmirësimit të cilësisë së shërbimit ndaj qytetarëve dhe të etikës së komunikimit.** Vërehet ende një nivel i ulët i njohurive të stafit të NJQVve mbi detyrimet ligjore, kapacitete të ulta në përthithjen dhe përdorimin e teknologjive të reja të informacionit, mungesë etike komunikimi, mungesë profesionalizmi në ofrimin e shërbimeve, trajtim preferencial bazuar në njohje personale, bindje politike, etj. Gjithashtu, konstatohet mungesë qëndrueshmërie e marrëdhënieve si pasojë e ndërrimit të liderëve apo stafeve të tyre. Trajnime e asistencë për stafet e NJQVve, përzgjedhja e tyre mbi bazën e meritokracisë, si dhe institucionalizimi i marrëdhënieve me OJFtë do të ndihmonin në këtë drejtim.
- **Përmirësimi dhe përshtatja e infrastrukturës fizike për personat me nevoja të veçanta.** Aksesin në informacion dhe shërbime për personat me nevoja të veçanta është shumë i vështirë, si pasojë e mungesës së infrastrukturës fizike të përshtatshme për ta.

- **Rritja e rolit të OJFve në politikëbërjen në nivel vendor dhe qendror.** Duke vlerësuar rolin kyç që OJFtë kanë në angazhimin qytetar për mbrojtjen dhe përfaqësimin e interesave të tyre, mbetet e rëndësishme rritja e pjesëmarrjes dhe rolit të tyre në hartim e zbatim politikash. Pasiviteti i vetë OJFve¹⁶, përfshirja e tyre në mënyrë sporadike dhe jo të qëndrueshme (si zgjedhje e vetë OJFve ose rezultat i politikës së NJQVve në këtë drejtim), kapaciteti jo në nivelet e duhura për të mobilizuar qytetarët apo për t'u përfaqësuar si sektor, janë disa nga problemet kryesore të sektorit që duhen adresuar. Një element shumë i rëndësishëm është edhe fuqizimi i demokracisë së brendshme dhe rritja e transparencës së OJFve, çka do të sillte rritjen e njohurisë së përfaqësuesve të qeverisë mbi sektorin dhe veprimtarinë e tij, të besimit dhe të shanseve për partneritet institucional bazuar në merita dhe jo preferenca. Këto si dhe bashkërendimi i aktivitetit të vetë OJFve brenda sektorit, do ta bënin këtë të fundit një aktor më të zëshëm në shoqëri.
- **Rritja e bashkëpunimit të OJFve me Qeverinë në të gjitha nivelet me qëllim inkurajimin dhe rritjen e aktivitetit të sektorit.**
 - Hartimi i strategjive të bashkëpunimit mes qeverisë (lokale e qendrore) dhe organizatave të shoqërisë civile etj.;
 - Krijimi i skemave financiare konkurruese për OJFtë me fonde të PV;
 - Nxitja e partneritetit OJF-Qeveri-Biznes.
- **Përmirësime në kuadrin ligjor e mundësues për sektorin e OJFve, veçanërisht mbi atë fiskal.** Mbas rreth një dekade pasi është zhvilluar kuadri ligjor për sektorin jofitimprurës, ai ende vuan nga shumë mangësi dhe lë vend për subjektivizëm në interpretim e ekzekutim. Mbas zhvillimeve të viteve të fundit, vlerësohet se kuadri ligjor për sektorin nuk mundëson qëndrueshmërinë e tij dhe cënon aktivitetin normal në marrëdhëniet e tij me shtetin.
- Vazhdon të ketë një boshllëk ligjor të qenësishëm që vështirëson punën e OJFve, aktivitetet e tyre ekonomike me përfitim social apo edhe shërbimet e ofruara prej tyre me fonde të buxhetit të shtetit. Plotësimi i tij do të ndikojë që OJFtë të bëhen më aktive dhe të kontribuojnë më efektivisht në zhvillimin social ekonomik të vendit. Në këtë drejtim, një rol të rëndësishëm mund të luante rishikimi i kuadrit ligjor dhe hartimi i ligjeve të reja në lidhje me sipërmarrjet sociale, filantropinë korporative, vullnetarizmin etj.

¹⁶ Ligji Nr.8503, datë 30.6.1999 "Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet Zyrtare"

- Një ndër problematikat kryesore të legjislacionit lidhet me kuadrin fiskal për OJFtë, i cili është evaziv dhe krijon vend për subjektivizëm dhe abuzim nga ana e tatimorëve. Çështja më problematike në legjislacionin fiskal ka qënë dhe mbetet TVSHja. Në kushtet e legjislacionit në fuqi, sektori nuk ka asnjë incentivë për t'u orientuar drejt ofrimit të shërbimeve përkundrejt pagesës, qoftë kjo edhe me tarifë të reduktuar. Raportimi i sektorit në shtet vazhdon të jetë njësoj edhe mbas 20 vjetësh si biznesi i madh, duke krijuar një pengesë të madhe financiare dhe administrative për OJFtë.
- **Përmirësime në ligjin mbi prokurimet publike.** Mekanizmi i kontraktimit social është një mjet shumë i rëndësishëm për të zhvilluar një sistem të mirë të shërbimit social dhe një burim i rëndësishëm për punën e organizatave që ofrojnë shërbime të tilla. Ligji aktual për prokurimet publike shihet si një pengesë dhe ngadalësues në marrëdhëniet e prokurimit të shërbimeve publike nga PV tek OJFtë që i ofrojnë këto shërbime e që kanë kapacitete të ngritura dhe eksperiencë e cila duhet shfrytëzuar. Në raportin e ECNLsë të cituar gjatë studimit, si dhe nga diskutimi në grupe të fokusuar me OJF e përfaqësues të PV, prokurimi i shërbimeve nga OJFtë mbetet problematik. Pengesat kryesore konstatohen në kuadrin rregullator dhe procedural të prokurimit të këtyre shërbimeve, i cili duhet përshtatur më tej për sektorin.
- **Rritja e ndërveprimit të OJFve me Institucionin e Avokatit të Popullit.** Institucioni i Avokatit të Popullit mbron të drejtat, liritë dhe interesat e ligjshme të individit nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike ose të tretëve që veprojnë për llogari të saj. Prej krijimit të tij, nuk është konstatuar ndonjë ndërveprim i konsiderueshëm dhe bashkëpunim me OJFtë, veçanërisht në nivel lokal. Nevojat e shumta të cilat ka sektori dhe grupet përfituese të cilave ai u shërben apo përfaqëson, do të adresoheshin shumë më mirë, në kohë dhe me efikasitet nëse do të kishte një bashkëpunim dhe koordinim më të madh me këtë institucion.

8. Referenca

- 1- Chetwynd, Eric and Chetwynd, Frances. (2001) *"A Practical Guide to Citizen Participation in Local Government in Romania"*. Research Triangle Institute under the Local Government Assistance Program, USAID. Romania.
- 2- TACSO. (2011) *OSHC-të dhe Pjesëmarrja e Qytetarëve në Proceset Vendimmarrëse*
- 3- OECD. *OECD Public Management, Policy Brief Engaging Citizens in Policy-Making: Information, Consultation and Public Participation*. PUMA, Policy Brief No.10, July 2001, fq. 2. [online]: <http://www.oecd.org/governance/public-innovation/2384040.pdf>
- 4- World Bank. (2009) *World Bank - Civil Society Engagement: Review of Fiscal Years 2007 to 2009* [online]: <http://siteresources.worldbank.org/CSO/Resources/CivilSocietyBook2009final.pdf>;
- 5- Partnerët Shqipëri. (2011) *Një Vështrim Historik mbi Zhvillimin e Filantropisë në Shqipëri*
- 6- HDPC. *Third Sector Development in Albania: Challenges and Opportunities*. [online]: http://www.euclidnetwork.eu/eu-funding-and-policy/resources/doc_view/119-third-sector-development-in-albania.html
- 7- TACSO. (2011) *Needs Assessment Report, Albania* [online]: http://www.tacso.org/doc/AL_NA_report.pdf;
- 8- DPPP. [online]: www.fint.gov.al/doc/Lista%20e%20OJF%20.xls
- 9- AMSHC. [online]: www.amshc.gov.al/web/doc/ligjore/LIGJ_Nr._10093_date_9.3.2009.pdf
- 10- ECNL. (2011) *Raport vlerësues i kuadrit fiskal për shoqërinë civile në Shqipëri* (raport i porositur nga Fondacioni i Shoqërisë së Hapur për Shqipërinë [online]: (http://www.partnersalbania.org/Assessment_Report_shqip.pdf)
- 11- Qendra e Publikimeve Zyrtare: <http://www.qbz.gov.al>
- 12- Kuvendi i Shqipërisë: <http://www.parlament.al>
- 13- Këshilli i Ministrave të Shqipërisë: <http://www.km.gov.al>
- 14- Avokati i Popullit: <http://www.avokatipopullit.gov.al>
- 15- Këshilli i Evropës: <http://hub.coe.int/web/coe-portal>



Partnerët Shqipëri,

Qendra për Ndryshim dhe Manaxhim Konflikti

Adresa: Rruga Sulejman Delvina,

N.18, H.8, Ap. 12, Njësia Bashkiake 5,

Kodi Postar 1022, Tiranë

Kutia postare 2418/1

Tiranë 2013